RREGULLORE
PËR MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONAT E LIDHUR ME TË

Baza ligjore dhe qëllimi
Neni 1

1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje janë ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve të bankës dhe degës së bankës së huaj me personat e lidhur me to.

1.3 Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi do t'i quajmë "bankë".

Përcaktimet
Neni 2

2.1 Me persona të lidhur kuptojmë dy ose më shumë individë dhe/ose persona fizikë dhe/ose persona juridikë, të cilët mund të jenë rezidentë ose jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, që për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje:

2.1.1 Plotësojnë kuptimin e termave të nenit 2 germat f dhe germa k të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur personi:

- ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës ose në kapitalin e një shoqërie tjetër, e cila është aksionere e bankës;
- ndikon në vendimmarrjen e bankës apo të shoqërisë tjetër aksionere të bankës,
- është zotërues direkt ose indirekt i një pjese të kapitalit që i jep atij 25 për qind ose më shumë të votave të organit më të lartë vendimmarrës të bankës ose të personit tjetër juridik;
- i vetëm, ka në dispozicion shumicën e votave në bankë ose te personi tjetër juridik, në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar me ortakët ose me aksionerët e tjerë;
- përcakton, *de facto* nëpërmjet të drejtës së votës që zotëron, vendimet e marra në mbledhjet e organit më të lartë të bankës ose të personit tjetër juridik, përfshirë dhe zgjedhjen dhe emërimin e administratorëve të bankës.

2.1.2 Janë administratorë të bankës, në përputhje me përcaktimet e bëra në rregulloren "Për administratorë të bankës dhe të degës së bankës së huaj", dhe familjarët e tyre.

Në zbatim të nenit 35 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me termin familjarë kuptojmë:

- bashkëshorti (a) dhe fëmijët;
- të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve a të motrave.

2.1.3 Sipas vlerësimit me shkrim të inspektorëve të mbikëqyrjes, janë financiarisht të lidhur, në mënyrë të tillë që vështirësitë financiare të njërit shkaktojnë vështirësi financiare të të tjerëve.

2.1.4 Për zbatimin e kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes, personat e lidhur konsiderohen si një kundërparti e vetme. Koeficienti i ponderimit për personat e lidhur njehsohet me koeficientin më të madh të ponderimit kur të paktën dy nga përbërësit e personave të lidhur kanë secili koeficientë të ndryshëm ponderimi.

2.2 Veprimet e bankës me personat e lidhur me të janë të gjitha veprimtaritë e lejuara të bankës, të kryera me personat e lidhur, të përcaktuara në pikën 2.1 të këtij neni.

Veprimet me personat e lidhur trajtohen nga banka, me të njëjtat terma dhe me të njëjtat kushte si veprimet me të gjithë klientët e tjerët të bankës.

2.3 Të drejtat ndaj personave të lidhur janë pjesë e veprimeve të bankës me personat e lidhur, në llogaritë e bilancit (kryegjë dhe interes) dhe/ose në llogaritë e jashtë bilancit të marra së bashku.

2.4 Të drejtat neto janë të drejtat ndaj personave të lidhur kur nga ato zbriten sipas radhës:

i) fondet rezevë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga të drejtat për secilën prej llogarive të bilancit dhe/ose të llogarive jashtë bilancit;

ii) garancitë dhe/ose kolaterali i marrë, kur këto garanci ose kolaterale plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren "Për kontrollin e risqeve të mëdha".

2.5 Të drejtat në rrezik janë të drejtat neto të ponderuara me koeficientët, të përcaktuara në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" dhe në përputhje me pikën 2.1.4 të këtij neni.

Kërkesat mbikëqyrëse

Neni 3

3.1 Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 37 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", përcakton kufizime për veprimet e bankës me personat e lidhur me të.

3.2. Për personat e lidhur të bankës që zotërojnë direkt dhe/ose indirekt jo më pak se 5 për qind të kapitalit të bankës, dhe/ose për personat sipas përcaktimit 2.1.2 dhe/ose 2.1.3 të nenit 2 të kësaj rregulloreje:

i) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 20 për qind të kapitalit rregullator;

ii) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 30 për qind të kapitalit rregullator kur personi i lidhur është një bankë;

iii) totali i të drejtave në rrezik të jetë jo më i madh se 300 për qind e kapitalit rregullator.

Kontrolli

Neni 4

4.1 Organet vendimmarrëse të bankës miratojnë rregulla dhe udhëzime të brendshme për:

i) drejtimin e rrezikut të veprimeve me personat e lidhur;

ii) politikat dhe procedurat për dhënien e kredive, në të cilat të theksohet shprehimisht se kushtet e kredive për personat e lidhur janë të njëjta me kushtet e të gjithë klientelës.

4.2 Subjektet e kësaj rregulloreje të sigurojnë një sistem monitorimi dhe informacioni të vazhdueshëm për veprimet me personat e lidhur. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të mbikëqyrë në çdo kohë sistemin e monitorimit dhe të informacionit të veprimeve me personat e lidhur.

Raportimi

Neni 5

5.1 Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë në Bankën e Shqipërisë për veprimet me personat e lidhur sipas formatit të raportimit bashkëlidhur.

5.2 Formularët e raportimit, nga subjektet e kësaj rregulloreje, plotësohen çdo muaj, ndërsa raportimi në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, në sektorin e inspektimeve në vend, të bëhet më vonë se 10 ditë nga fundi i çdo tremujori. Inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes kanë të drejtë të përcaktojnë afate më të shpeshta raportimi, kur e gjykojnë të arsyeshme.

Përfundimtare

Neni 6

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.100, datë 10.12.2003 të Këshillit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

FORMULARI NR.1
MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR

Emri i bankës…….

Periudha raportuese……..
Data e raportimit……..
Përgatiti (Emër, mbiemër, firmë)
Drejtuesi (Emër, mbiemër, firmë)

Përbërja	Të drejtat (1)	Detyrimet (2)	Veprimet jashë – bilancit (të dhëna) (3)	Veprimet jashtë-bilancit (të marra) (4)
a. Individ:				
----------				
b. Person fizik:				
----------				
c. Person juridik:				

1.Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////////	//////////////		
a. Individ:				
----------				
b. Person fizik:				
----------				
c. Person juridik:				
----------				
2. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////////	//////////////		

----------				
a. Individ				
----------				
b. Person fizik:				
----------				
c. Person juridik:				
----------				
n. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////////	//////////////		
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)	//////////////	//////////////		

FORMULARI NR.2
KËRKESAT MBIKËQYRËSE TË VEPRIMEVE TË BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR

Emri i bankës…….
Periudha raportuese……..
Data e raportimit……..

Përgatiti (Emër, mbiemër, firmë) Drejtuesi (Emër, mbiemër, firmë)

Kapitali rregullator	Shumat
(20%) e kapitalit rregullator:	//////////////////////////
(30%) e kapitalit rregullator:	//////////////////////////
(300%) e kapitalit rregullator:	//////////////////////////

Veprimet me personat e lidhur	Të drejtat (1) [1]	Fondet rezervë (2)	Garancitë dhe/ose kolateralet e marra (3)	Të drejtat neto (4) = (1) – {(2) + (3)}	Ponderimi (5)	Të drejtat në rrezik (6)=(4)*(5)
1. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
2. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
n. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)						

[1] Në këtë kolonë regjistrohen shuma e të dhënave të kolonës 1 dhe të dhënat e kolonës 3 (për zërat jashtë bilanci), të nxjerra nga formulari nr.1.

PËR DISA NDRYSHIME
NË RREGULLOREN "PËR VEPRIMTARINË VALUTORE",
MIRATUAR ME VENDIM NR. 64, DATË 30.7.2003
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në udhëzimin 1 të rregullores "Për veprimtarinë valutore", miratuar me vendim nr.64, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1.1 germa b ndryshohet si vijon: "fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës".

2. Pika 2.1 germa b ndryshohet si vijon: "fatura përkatëse e subjektit-ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës, dhe/ose kontrata dhe/ose marrëveshja përkatëse".

3. Pika 2.1 germa c shfuqizohet.

4. Pika 1.1 germa c1 ndryshohet si vijon: "në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e radhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar. Përjashtim bëjnë rastet kur afati i livrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj."

5. Pika 1 "Transfertat për veprimet tregtare për mallrat" shtohet pika 1.5 me këtë përmbajtje:

" 1.5 Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë për shumat deri në 3.5 milionë lekë ose ekuivalenten e saj në monedhë të huaj të llogaritur me kursin e ditës së kryerjes së pagesës:

a) Kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera.

b) Akti i zhdoganimit të mallit sipas rasteve të parashikuara në pikën 1.1. germa c.".

6. Këto ndryshime u miratuan me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI

Shkëlqim Cani